



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Data/Date/Datum:	11.07.2024
Për/To/ Za:	Kryetarin e Komunës z. Alban Hyseni
Cc:	
Përmes/ Through/ Preko	
Nga/From/Od:	Ardian Foniqi – Zyrtar për konsultime Publike
Lënda/ Subject/Tema:	<b>Raport i Konsultimeve Publik, Buxhetimit me Pjesëmarrje 2024</b>

## **RAPORT PËRMBLEDHËS PËR BUXHETIMIN ME PJESËMARRJE**

## Qershor, 2024

### Përmbajtja:

Përmbajtja:.....	2
Hyrje.....	3
Përcaktimi i kriterëve për zgjedhjen e lokaliteteve (fshatrave dhe lagjeve urbane) .....	3
Përcaktimi i kriterëve të përgjithshme për financimin e projekteve.....	3
Përgatitjet për organizimin e procesit.....	4
Procesi i propozimit të projekteve .....	5
Njoftimi i qytetarëve mbi ditën e votimit të projektit për financim .....	5
Takimet e para.....	6
Hapat e ardhshëm.....	10
Takimet e dyta – votimi.....	10
Sfidat dhe rekomandimet në procesin e buxhetimit me pjesëmarrje: .....	12

## Hyrje

Në përpjekje për të përfshirë qytetarët në procesin e vendimmarrjes dhe për të rritur transparencën në shpenzimin e buxhetit vjetor, komuna e Gjilanit ka inicuar buxhetimin me pjesëmarrje në katër lokacione dhe me tre grupe të komuniteteve jo-shumicë. Këtë vit, fshatrat si Malishevë, Kravaricë, Velekinçë, dhe Livoq i Ulët, si dhe komunitetet rom, serb, dhe turk, janë përzgjedhur për të testuar këtë nismë. Qëllimi është të ofrojë qytetarëve mundësinë për të marrë pjesë aktive në vendimmarrje dhe në shpenzimin e fondeve komunale, duke propozuar dhe votuar projekte për lokalitetet e tyre.

Iniciativa e buxhetimit me pjesëmarrje fuqizon qytetarët për të vendosur mbi ndarjen e fondeve publike drejt projekteve që përfitojnë komunitetin e tyre. Kjo qasje bazohet në parimin që qytetarët kuptojnë më mirë problemet dhe prioritetet e komunitetit të tyre. Pjesëmarrja e tyre në buxhetim siguron përdorimin efektiv të fondeve komunale dhe adreson çështjet e rëndësishme për ta.

## Përcaktimi i kriterëve për zgjedhjen e lokaliteteve (fshatrave dhe lagjeve urbane)

Për të realizuar një proces të suksesshëm të buxhetimit me pjesëmarrje, fillimisht është e rëndësishme të përcaktohen lokalitetet apo grupet me të cilat do të realizohet procesi. Kriteret për përzgjedhjen e lokaliteteve dhe grupeve për buxhetim me pjesëmarrje janë të rëndësishme për të siguruar një proces të drejtë, transparent dhe efektiv. Ato përdoren për të identifikuar dhe përzgjedhur zonat dhe grupet që do të përfitojnë më shumë nga ky proces dhe për të garantuar që fondet publike të shpërndahen në mënyrë të drejtë dhe efikase.

Në komunën e Gjilanit përzgjedhja e lokaliteteve dhe grupeve të komuniteteve është bërë duke zbatuar kriteret si më poshtë:

1. Lokalitetet apo fshatrat ku ka më pak investime
2. Numri i madh i banorëve përfitues
3. Përfshirja e së paku një zone rurale dhe të më të largët me pjesën e qytetit
4. Përfshirja e komuniteteve jo-shumicë
5. Komunitetet me mungesë të infrastrukturës bazë dhe shërbimeve publike

Përfshirja e lokaliteteve ose fshatrave me nivele më të ulëta të investimeve siguron që fokusi i buxhetimit të drejtohet atje ku është më i nevojshëm dhe më i dobishëm. Gjithashtu, përfshirja më e madhe e qytetarëve duket targetuar fshatra më të mëdha siguron që fondet publike të shpërndahen në mënyrë efektive për një numër më të madh të njerëzve. Përfshirja e lokaliteteve me pozita më të largëta gjeografike mundëson që edhe komunitetet më të largëta dhe më të izoluar të kenë qasje në burime dhe shërbime publike. Komuna e Gjilanit synon që nevojat e komuniteteve jo-shumicë të adresohen dhe përmbushen, kështu duke promovuar barazinë dhe diversitetin. Gjithashtu në adresimin e nevojave urgjente dhe në mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm të këtyre komuniteteve, duke përmirësuar jetën e përgjithshme dhe mundësitë e tyre për zhvillim.

## Përcaktimi i kriterëve të përgjithshme për financimin e projekteve

Përmes buxhetimit me pjesëmarrje, qytetarëve u ofrohet mundësia të përfshihen në mënyrë aktive në procesin e vendimmarrjes dhe të kenë rol kyç në mënyrën se si shpenzohen fondet komunale.

Për të siguruar një proces sa më demokratik dhe transparent, grupi punues për konsultime publike me asistencën e ofruar nga projekti Agjenda Kontrata Sociale (SCA), kanë definuar disa kriteret të cilat janë të nevojshme për përzgjedhjen e duhur të projekteve.

Kriteret të cilat i ka vendosur komuna për financimin e projekteve janë:

- Lloji i projekteve: Investime Kapitale
- Projekt-propozimi të jetë brenda kornizave të buxhetit të prezentuar nga komuna
- Numri i përfituesave nga projekti i propozuar të jetë sa më i madh, sidomos në rastet e barazimit të votave
- Projekti të ketë ndikim social, ekonomik dhe mjedisor
- Projekti të jetë gjithëpërfshirës duke përfshirë grupe të marginalizuara, veçanërisht gratë dhe rinjtë
- Lokacioni i projektit të propozuar të jetë në pronësi të komunës ku disponueshmëria konfirmohet zyrtarisht nga komuna

## Përgatitjet për organizimin e procesit

Procesi përfshin angazhimin e qytetarëve dhe grupeve të ndryshme të interesit në procesin e vendimmarrjes për përzgjedhjen e projektit dhe financimit nga buxheti vjetor i komunës për vitin 2025. Për të organizuar fazën e parë, janë zhvilluar takime përgatitore me grupin punues për konsultime publike, drejtorë dhe zyrtarë të komunës. Është hartuar një koncept-Plan i Komunikimit dhe Veprimit, të cilat do të pasojnë me organizimin e punëtorive dhe sesioneve informuese. Punëtoritë me grupin punues janë mbajtur me qëllim të informimit dhe koordinimit të punëve dhe detyrave në mes të antarëve gjatë organizimit të buxhetimit me pjesëmarrje. Eshtë realizuar një fushatë informuese duke përdorur media sociale dhe portale lokale, si dhe postera informuese në vende më të frekuentuara. Takime informuese duke përfshirë përfaqësues të lokacioneve dhe grupeve të komuniteteve jo-shumicë, dërgimin e ftesave të personalizuara për të gjithë qytetarët e lokaliteteve të targetuara. Në anën tjetër, janë mbajtur sesione informuese nëpër lokalitete dhe me grupe të komuniteteve jo-shumicë të cilat janë mundësuar nga projekti Agjenda e Kontratës Sociale përmes organizatës partnere D+. Njoftimet dhe ftesat publike janë bërë në gjuhët përkatëse të të gjitha komuniteteve që jetojnë në komunën e Gjilanit (serb, turq dhe rom).

 <b>THIRRJE PUBLIKE</b> Fshati <b>Livoç i Ulët</b> Merr pjesë, vendos!	 <b>THIRRJE PUBLIKE</b> Fshati <b>Kravaricë</b> Merr pjesë, vendos!	 <b>JAVNI POZIV</b> Srbska <b>Zajednica</b> Učestvujte, odlučite!
Data: 4 Qershor 2024 Ora: 18:00 Vendi: SHFMU 'Deshmoret e Kombit'	Data: 5 Qershor 2024 Ora: 18:00 Vendi: Shkolla e Fshatit	Datum: 07.06.2024 Vreme: 18:00 Mesto: Deçji vrtić sela Šilova
Takim informues me banorët e fshatit Livoç i Ulët	Takim informues me banorët e fshatit Kravaricë	Informativni sastanak sa građanima srpske zajednice



### 1. Posterët informuese për takimet e para të buxhetimit me pjesëmarrje

## Procesi i propozimit të projekteve

Takimet e para publike për buxhetimin me pjesëmarrje u zhvilluan në një atmosferë konstruktive dhe interaktive. Qytetarët paraqitën dhe diskutuan ide për projekte që mund të financohen nga buxheti komunal. Shuma totale e financimit të dedikuar për buxhetimin me pjesëmarrje për këtë vit është 280,000 Euro, e cila do të ndahet sipas specifikave të lokacioneve dhe grupeve të komuniteteve. Përfaqësuesit komunal luajtën një rol kyç në filtrimin e ideve dhe përzgjedhën tri deri pesë idetë më të rëndësishme për votim më tutje.

Pas verifikimit për plotësim të kriteve nga komuna, një nga projektet do të zgjidhet për financim përmes votimit publik, duke lejuar qytetarët të kenë fjalën e fundit në përzgjedhjen e projektit që do të sjellë përfitime më të mëdha për komunitetin e tyre.

## Njoftimi i qytetarëve mbi datën e votimit të projektit për financim

Qytetarëve u është ofruar mundësia të përfshihen në procesin e vendimmarrjes direkte duke marrë pjesë në procesin e votimit për përzgjedhjen e projektit që do të financohet nga komuna.

Zyrtarët komunal të angazhuar në këtë proces, kanë përdorur mënyra të ndryshme të informimit duke filluar nga njoftimet zyrtare në web-faqe të komunës, si dhe duke përdorur mediat elektronike, platformat sociale për të shpërndarë sa më shumë informatat. Gjithashtu, është bërë edhe shpërndarja e posterëve dhe njoftimeve nëpër lokalitete si dhe në vende më të frekuentuara.

Qytetarët janë njoftuar për datën e votimit dhe janë inkurajuar të marrin pjesë dhe të ushtrojnë rolin e tyre aktiv në proceset demokratike.



2. Posteret informues për datat e votimit

Takimet e para

1. Takimi në Malishevë (3 qershor 2024)

- Pjesëmarrës: 21 qytetarë, të gjithë burra
- Projekte e prioritzuara nga takimi i parë:
  - Park në 'Lagjen e Çelikeve'
  - Muri mbrojtës në lagjen 'Rustollët'
  - Terren sportiv dhe kënd lodrash
  - Rrethoja e shkollës
  - Park në hapësirën afër shkollës
- Buxheti: 40,000 Euro
- Data e votimit: 18 qershor

2. Takimi në Livoq të Ulët (4 qershor 2024)

- Pjesëmarrje: 20 qytetarë (19 burra dhe 1 grua)

- Projekte e prioritizuara nga takimi i parë:
  - Park në qendër të fshatit
  - Rregullimi i parkut pranë rrugës “Ekrem Shabani”
  - Kënd i lojërave
  - Rregullimi i ndriçimit në fshat
- Buxheti: 40,000 euro
- Data e votimit: 19 qershor

### 3. Takimi me komunitetin rom (5 qershor 2024)

- Pjesëmarrje: 33 qytetarë (23 burra, 7 gra, dhe 3 fëmijë)
- Projekte e prioritizuara nga takimi i parë:
  - Park për fëmijë
  - Terren sportiv
  - Rregullimi i ujësllësit
  - Rregullimi i ndriçimit publik
- Buxheti: 40,000 Euro
- Data e votimit: 20 qershor

### 4. Takimi në Kravaricë (5 qershor 2024)

- Pjesëmarrje: 11 qytetarë (7 burra dhe 4 gra)
- Projekte e prioritizuara nga takimi i parë
  - Terren sportiv
  - Ndriçimi i rrugës për tek shkolla,
  - Rregullimi i rrugës deri tek shkolla
  - Park për fshatin
- Buxheti: 30,000 Euro
- Data e votimit: 20 qershor

### 5. Takimi në Velekincë (6 qershor 2024)

- Pjesëmarrje: 45 qytetarë, të gjithë burra
- Projekte e prioritizuara nga takimi i parë:
  - Park pranë shkollës
  - Klasë verore brenda shkollës
  - Kënd i lojërave
  - Park në lagje
  - Laborator në shkollë
  - Rregullimi i rrugëve alternative tek tregu i kafshëve
- Buxheti: 50,000 Euro

- Data e votimit: 21 qershor

#### 6. Takimi me komunitetin turk (7 qershor 2024)

- Pjesëmarrje: 14 qytetarë, të gjithë burra
- Projekte e prioritizuara nga takimi i parë:
  - Asfaltimi i disa rrugëve në lagjet e komunitetit turk
  - Parqe në disa lagje
  - Vendosja e gypit nga Banja deri tek parku
  - Rregullimi i një hapësire për komunitete
- Buxheti: 40,000 Euro
- Data e votimit: 22 qershor

#### 7. Takimi me komunitetin serb (12 qershor 2024)


- Pjesëmarrje: 6 qytetarë, të gjithë burra
- Projekte e prioritizuara nga takimi i parë:
  - Sallë sportive në fshatin Shillovë
  - Ndërrimi i gypave të sistemit të ujësjellësit në Shillovë
  - Ri-asfaltimi i rrugës kryesore në Shillovë
- Buxheti: 40,000 Euro
- Data e votimit: 26 qershor

Paraqitje tabelare e pjesëmarrësve:

Lokacioni/grupet e komuniteteve jo-shumice	Data	Pjesëmarrës	Burra	Gra	Fëmijë
Malishevë	3 qershor	21	21	0	0
Livoq të Ulët	4 qershor	20	19	1	0
Komuniteti Rom	5 qershor	33	23	7	3
Kravaricë	5 qershor	11	7	4	0
Velekincë	6 qershor	45	45	0	0
Komuniteti Turk	7 qershor	14	14	0	0
Komuniteti Serb	7 qershor	6	6	0	0
<b>Total!</b>		<b>150</b>	<b>135</b>	<b>12</b>	<b>3</b>

<sup>1</sup> Numri i pjesëmarrësve është evituar gjatë pjesëmarrjes në takim dhe fotove të bëra gjatë takimeve.





*Foto nga takime e para - procesi i marrjes se propozimeve.*

## Hapat e ardhshëm

- ❖ Zhvillimi i fushatës informuese për datat e votimit të projekteve përmes njoftimeve, duke përdorur, posteret informues, shpërndarjen e informatave për datat e votimit në platformat digjitale dhe mediale (Facebook, portale dhe media lokale, etj).
- ❖ Organizimi i takimeve të dyta, votimet nëpër lokalitete dhe me grupet e komunitetve jo-shumicë.

## Takimet e dyta – votimi

### 8. Takimi në Malishevë (18 qershor 2024)

- Pjesëmarrës: 26 qytetarë (24 burra dhe 2 gra)
- Projekti fitues i përzgjedhur nga qytetarët:
  - Park në hapësirën afër shkollës
- Buxheti: 40,000 Euro

### 9. Takimi në Livoq të Ulët (19 qershor 2024)

- Pjesëmarrje: 81 qytetarë (70 burra dhe 11 gra)
- Projekti fitues i përzgjedhur nga qytetarët:
  - Park në qendër të fshatit
- Buxheti: 40,000 euro

### 10. Takimi me komunitetin rom (20 qershor 2024)

- Pjesëmarrje: 9 qytetarë (8 burra, 1 grua)
- Projekti fitues i përzgjedhur nga qytetarët:
  - Rregullimi i ndriçimit publik
- Buxheti: 40,000 Euro

### 11. Takimi në Kravaricë (20 qershor 2024)

- Pjesëmarrje: 14 qytetarë (11 burra dhe 3 gra)
- Projekti fitues i përzgjedhur nga qytetarët:
  - Terren sportive
- Buxheti: 30,000 Euro

### 12. Takimi në Velekincë (21 qershor 2024)

- Pjesëmarrje: 56 qytetarë (40 burra, 16 gra)
- Projekti fitues i përzgjedhur nga qytetarët:
  - Park pranë shkollës
- Buxheti: 50,000 Euro

### 13. Takimi me komunitetin turk (22 qershor 2024)

- Pjesëmarrje: 5 qytetarë, të gjithë burra
- Projekti fitues i përzgjedhur nga qytetarët:
  - Asfaltimi i disa rrugëve në lagjet e komunitetit turk
- Buxheti: 40,000 Euro

### 14. Takimi me komunitetin serb (22 qershor 2024)

- Pjesëmarrje: 18 qytetarë, të gjithë burra
- Projekti fitues i përzgjedhur nga qytetarët:
  - Sallë sportive në fshatin Shillovë
- Buxheti: 40,000 Euro

Paraqitje tabelare e pjesëmarrësve ne votim:

Lokacioni/grupet e komuniteteve jo-shumice	Data	Pjesëmarrës	Burra	Gra
Malishevë	18 qershor	26	24	2
Livoq të Ulët	19 qershor	81	70	11
Komuniteti Rom	20 qershor	9	8	1
Kravaricë	20 qershor	14	11	3
Velekincë	21 qershor	56	40	16
Komuniteti Turk	22 qershor	5	5	0
Komuniteti Serb	22 qershor	18	18	0
<b>Total:</b>		<b>209</b>	<b>176</b>	<b>33</b>





Foto nga takime e dyta - procesi i votimit.

## Sfidat dhe rekomandimet në procesin e buxhetimit me pjesëmarrje:

Procesi i buxhetimit me pjesëmarrje është një praktikë demokratike që kërkon përmirësime të vazhdueshme në menaxhimin e burimeve publike dhe në angazhimin e komunitetit. Ky proces përballë sfidave të ndryshme kërkon vëmendje dhe veprime të përshtatshme për t'u siguruar që buxheti të reflektojë nevojat dhe prioritetet e të gjithë qytetarëve. Disa nga sfidat kryesore gjatë këtij procesi përfshijnë:

### I. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi gjinor:

- **Sfida:** Në disa takime, përfaqësimi gjinor është i ulët dhe i pabarabartë, duke rezultuar në mungesë të zërit të grave në procesin e vendimmarrjes.
- **Rekomandime:** Është e nevojshme të ndërmerren masa për të siguruar një përfaqësim më të gjerë dhe më divers të komunitetit. Kjo mund të arrihet përmes fushatave të vetëdijesimit dhe krijimit të mekanizmave që inkurajojnë dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e grave dhe grupeve të tjera të nënpërfaqësuar.

## **Përfundim**

Duke adresuar këto sfida dhe duke marrë parasysh këto rekomandime, komuna e Gjilanit mund të përmirësojë ndjeshëm procesin e buxhetimit me pjesëmarrje. Kjo do të kontribuojë në një proces më transparent, më të drejtë dhe më efektiv, që adreson më mirë nevojat dhe prioritetet e qytetarëve të saj.

**Data: 27 qershor 2024**